



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:146816

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05695807

**P.nr.275/2023**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarës Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit M.S., nga fshati T., Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me numër PP.II.nr.991/2023, të datës 27.06.2023, pas konstatimit të dhënave në aktakuzë, të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor, me datë 16.05.2024, mori këtë:

### AKTGJYKIM

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.991/2023, e datës 27.06.2023 dhe kjo gjykatë, jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri **M.S.**, nga babai I., nëna M., e gjinisë I., i lindur me datë ....., në Gjilan, me vendbanim në fshatin T., komuna Viti, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të varfër, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 19.06.2023, rreth orës 09:00, në fshatin T., Komuna Viti, Policia e Kosovës, në bazë të urdhrit verbal të marrë nga gjyqtari i procedurës paraprake, ka kontrolluar shtëpinë dhe objektet përcjellëse të të pandehurit dhe gjatë kontrollimit të shtëpisë, në dhomën e gjumit, policia ka gjetur dhe sekuestruar substancë narkotike, e që sipas testit fushor substanca narkotike ka rezultuar të jetë e llojit "M.", me peshë 2.0 gram, me çka i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit "M."

-me çka ka kryer veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 43 të KPRK-së dhe nenit 450, 458, 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, të pandehurit të lartcekur:

## **I SHQIPTON** **Dënim me gjobë**

Ashtu që për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me gjobë në shumën prej 400.00 € (katërqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet t'a paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, ose nuk mund t'a paguajë gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzet) të dënimit me gjobë.

Konform nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së, substanca psikotropike "M", në sasi prej 2.0 gram, konfiskohet, e cila pas marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi e njëjta do të asgjësohet nga zyrtarët policor në Viti, të cilët janë të obliguar të përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e substancës narkotike të llojit "M", dhe të njëjtin duhet t'ia bashkëngjesin lëndës përkatëse.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) €, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### **Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 04.07.2023, në Gjykatën Themelore Gjilan, Dega e gjykatës në Viti, ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.991/2023, të datës 27.06.2023, ndaj të pandehurit M.S., nga fshati T., Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së.

Me te njëjtën datë sikurse aktakuza, është paraqitur kërkesa PP.II.nr.991/2023, e datës 27.06.2023, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me shqiptimin e dënimit me gjobë, me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPRK-së.

Gjykata pas leximit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjeti se në këtë çështje penalo juridike, janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPPRK-së për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe bazuar në nenin 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, vendosi që të pranojë kërkesën e lartë cekur ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkëngjitura në të, ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit R-2023-XI-DKKO-HTN-GJI-120, i datës 19.06.2023, deklaratat e të pandehurit M.S., kërkesa për ekzaminimin e substancës narkotike, raporti njoftues për test fushor, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, raport njoftues për bastisje të dhënat nga data-baza e policisë dhe prokurorisë për të pandehurin, raporti i oficerit policor I.T., raporti i ekspertimit , i datës 04.08.2023, punuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzike si dhe dokumentacioni tjetër përcjellës, gjeti se këto janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme mbi bazën e të cilave konstatohet bindshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues.

Andaj, bazuar në të lartë cekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë, ashtu siç është propozuar në kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e sendit është bazuar në nenin 269 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që gjykata ka vendosur që të konfiskohet substanca narkotike e llojit “Marihuanë”, në sasi prej 2.0 gram e evidentuar në vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 19.06.2023, i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Gjilan, ngase bazuar në nenin 276 paragrafi 2, pika 2.4, e njëjta i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, pasi që e njëjta është përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 276 paragrafi 4 të KPRK-së, do të asgjësohet.

Vendimin sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata e mori duke u mbështetur në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat dhe mbështetur në nenin 495 paragrafi 1, 2 dhe 3, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.275/2023, me datë 16.05.2024**

**Gjyqtarja,**  
**Blerina Jakupi Ramadani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, gjyqtarës individuale të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhërin ndëshkimor merr formën e prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.